



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:018990
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05638701

PA1.nr.1055/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ilmije Rexhepi Beqiri si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.M nga Prizreni, për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e të dëmtuarit A.M, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë- Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.11/2022 të dt.23.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 24.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar ankesa e e të dëmtuarit A.M, **ndryshohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë- Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.11/2022 të dt.23.03.2023, lidhur me vendimin mbi dënimin, ashtu që të pandehurit Altin Morina për veprën penale për te cilën është shpallur fajtor i shqipton dënim me gjobë në shumën katërqind (400) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, atëherë dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do ti llogaritet një ditë burgim.

Ne pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pandryshuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë- Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, me aktgjykimin P.nr.11/2022 të dt.23.03.2023, të akuzuarin A.M, e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, atëherë të akuzuarit dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) €. I dëmtuari A.H.M nga Rahoveci, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil. Detyrohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30) Euro si dhe në emër të kompensimit për viktimat e krimit shumën prej tridhjetë (30) Euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

I dëmtuari A.M për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar lidhur me vendimin mbi dënimin, në atë mënyrë që të pandehurit ti shqiptoj një dënim dukshëm më të lart apo çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1091/2023 të datës 31.08.2023, ka propozuar që të aprovohet ankesa e të dëmtuarit ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i lartë apo çështja të kthehet në rigjykim..

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është atakuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarës e të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e tij.

I dëmtuari A.M, e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me pretendimet se pala e dëmtuar ka një reputacion është profesor dhe ngjarja që ka ndodhur në palestrën sportive në Rahovec në të cilën vend i dëmtuari si profesor i edukatës fizike dhe kryen stërvitjes me basketbollistë, është sulmuar nga i akuzuari duke me shkaktuar lëndim trupor, me të cilin me ka njollos personalitetin e tij në shoqëri si

pedagog dhe profesor, për arsye të cekura paraqet edhe ankesë. Andaj në bazë të rrethanave në të cilat është zhvilluar ngjarja ditën kritike, motivet të ulëta të akuzuarit gjatë kryerjes së veprës penale, intesitetit dhe dëmtimit të së mirës, në këtë rast shëndetin e të dëmtuarit, rrethana personale të kryerësit dhe shkallën e përgjegjësisë të të akuzuarit. po të ishin vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes të dënimit, për të akuzuarin do të shqiptohej një dënim dukshëm më i lartë, në atë mënyrë që dënimi të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit. Në rastin konkret me shqiptimin e dënimit nuk është marrë për bazë parimi i preventivës të përgjithshme, me të cilit dënim do të mund të arrinte që të ngrit moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, që në të ardhmen këto lloje të veprave penale të mos shkaktohen nga personat të cila janë të gatshëm të i shkaktojnë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të të dëmtuarit që ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim më i lartë janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ku gjatë matjes së shqiptimit të dënimit në pajtim me dispozitat e nenit 69 të KPK-së, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh sjelljen korrekte të të akuzuarit në gjykim, është penduar për veprimin e bërë, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i njëjti është deklaruar i fajshëm, se i vjen keq për rastin e ndodhur, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë një veprim të tillë, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit ia ka shqiptuar dënimin me gjobë me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së.

Një konstatim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, mirëpo kolegji vlerësoi se gjykata e shkallës së parë i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese. Kolegji vlerësoi se është e vërtetë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë mirëpo ky fakt nuk mund të vlerësohet deri në këtë masë që të akuzuarit të shqiptohet një dënim i ulët si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, kjo për shkak të rrezikshmërisë së veprës penale dhe mënyrës së kryerjes së veprës penale. Të gjitha këto rrethana, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga kjo gjykatë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj marrë parasysh rrethanat e lartpërmendura, dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intesitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbejë preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitivin e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 403 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1055/2023, më datë 24.04.2024

Procesmbajtësja,
Ilmije Rexhepi Beqiri

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Abdulla Ahmeti

Zyhdi Haziri
